

VENDIM
Nr. 138, datë 20.2.2013

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESEM, 2014 - 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, 2014 - 2016, sipas lidhjes nr. 1 “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha